



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES
LEJE ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E LINJAVE TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE 110 KV BANJË – CËRRIK DHE
220 KV, MOGLICË – ELBASAN II

MIRATOHET
KRYETARI I KËSHILLIT

Z. EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJËRMENTI
Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

Z. DAMIAN GJIKNURI

Ministër i Energjisë dhe Industrisë

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 3, Datë 30.07.2014

Projektues: **DOKO sh.p.k**



TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
 - 1.3 Përkufizimi i termave të përdorur
2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)
 - 2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV
 - 2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit
 - 2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)
 - 3.1 Informacion për topografinë e zonës.
 - 3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)
 - 3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike
 - 3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj
 - 3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave
 - 4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa
 - 4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave
 - 4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë
 - 4.5 Rregullat e zhvillimit
 - 4.6 Vendqëndrimi për automjetet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave
 - 5.1.1 Rrjeti Rrugor
 - 5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike
 - 5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit
 - 5.1.4 Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza
 - 5.1.5 Impianti i furnizimit me ujë
 - 5.1.6 Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut
 - 5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta
6. Fazat e Zhvillimit të Lejes Zhvillimore Komplekse
7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.
8. Impaktet Kryesore në Mjedis
 - 8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës

- 8.2 Impakt mbi ujërat sipërfaqësore
 - 8.3 Impakt mbi ujërat nëntokësore
 - 8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)
 - 8.5 Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve
 - 8.6 Impakt mbi Peizazhin
 - 8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin
 - 8.8 Impakt mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë
9. Aneksë (Hartat në format A3)

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 Baza Ligjore Kryesore:

- Kontrata e Koncesionit datë 19 Dhjetor 2008, ratifikuar me ligjin nr. 10 083 datë 23.02.2009 ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Republikën e Shqipërisë ("METE" ose "Autoriteti Kontraktues") dhe EVN A.G, Statkraft AS dhe Shoqërisë së Projektit Devoll Hydropower Sh.A, Bashkë-Koncesionarë në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin dhe mirëmbajtjen e HEC- it të Banjes, atë të Kokel-it, dhe të Moglicës;
- "Kontrata për Zgjerimin e Ndërtimit dhe Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit", për ndërtimin e dy linjave të transmetimit, respektivisht atë 110 kV dhe 220 kV të DHP-së në kuadër të implementimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit;
- Ligji nr. 10 119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar.
- VKM nr. 502, datë 30.07.2011, "Për miratimin e Rregullores Uniforme për Kontrollin e Zhvillimit të Territorit", Shtojca 2.

Te tjera:

- Vendim nr. 661, datë 7.8.2013 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave 110 kV dhe 220 kV që lidhin kaskadën e Devollit me sistemin e transmetimit të Republikës së Shqipërisë"
- Urdhër 506 dt.22.05.2013 të MMPAU për të drejtën e kalimit dhe përdorimit të fondit pyjor për linjat 110-220 kV.

1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

1.2.1 Hidrocentrali i Banjës 110 kV – Nënstacioni i Cërrikut

Objekti i punimeve për kontraktuesin e Linjave të Transmetimit përfshin lidhjen e hapësirave të lira me platformën në stacionin e seleksionimit të Hidrocentralit të Banjës, duke përfshirë telat lidhës të përcjellësit të tokëzimit me fibër optike për në kutinë e lidhjes së kabllave në platformë. Furnizimi i kutisë së lidhjes së kabllave në platformë dhe lidhja kabllore e OPGW-ve është përgjegjësi e kontraktuesit Elektro-mekanik.

- Sipas Kontratës së Koncesionit datë 19 Dhjetor 2008, ratifikuar me ligjin nr. 10 083 datë 23.02.2009 ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në Republikën e Shqipërisë ("METE" ose "Autoriteti Kontraktues") dhe EVN A.G, Statkraft AS dhe Shoqërisë së Projektit Devoll Hydropower Sh.A, Bashkë-Koncesionarë në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, zotërimin, operimin dhe mirëmbajtjen e HEC- it të Banjës, atë të Kokel-it, dhe të Moglicës;
- Kaskada e hidrocentralit të Devollit që përfshin dy hidrocentrale: hidrocentralin e Moglicës (177 MW) të ndodhur në pjesën nëntokësore në bregun e djathtë të bjeftit të

sipërm të bashkërrjedhjes së degës Grabovë me Lumin Devoll, si dhe hidrocentralin e Banjës (65 MW) të ndodhur në Digën e Banjës, do të lidhet me rrjetin energjetik shqiptar me dy linjat e mëposhtme të transmetimit;

- Linjën me një qark të vetëm 110 kV nga hidrocentrali i Banjës në Nënstacionin e Cërrikut
- Linjën me qark të dyfishtë 220 kV nga hidrocentrali i Moglicës në Nënstacionin Elbasan II

Dy linjat e transmetimit të detajuara dhe të rilevuara kanë gjatësinë e linjave dhe numrin e shtyllave/kullave si më poshtë.

Linja 220 kV

Linja 110 kV



Lloji	Emri	Gjatësia e Linjës	Numri i shtyllave/kullave
110 kV	Hidrocentrali i Banjës-Nënstacioni Cërrik	12.9 km	44
220 kV	Hidrocentrali i Moglicës- Nënstacioni II Elbasan	48.8 km	110

1.2.2 Hidrocentrali i Moglicës 220 kV – Nënstacioni Elbasan II

Objekti i punimeve të Linjave të Transmetimit përfshin furnizimin e materialeve për të gjitha lidhjet e hapësirave të lira me të gjitha platformat e nënstacioneve dhe stacioneve të seleksionimit, përfshirë telat lidhës të përcjellësve të tokëzimit me fibër optike (OPGW) për në kutitë e lidhjes së kablllove në platforma. Furnizimi i kutive të lidhjes së kablllove të platformave dhe lidhja kablllore e OPGW-ve në platformë do të jetë përgjegjësi e kontraktuesit elektromekanik (EM).

Zgjerimi i linjës 220 kV nëpërmjet Hidrocentralit të Kokelit

DHP ka vendosur të shtyjë ndërtimin e Hidrocentralit të Kokelit (Referencë: Ndryshimi i Kontratës së Konçesionit). Megjithatë, koordinimi i linjës së transmetimit 220 kV ka mbetur i pandryshuar për lidhjen e ardhshme nga dy antena terminali të tipit Rover në lumin Devoll për në centralin elektrik pas ndërtimit.

Të dy përcjellësit ajrorë të tokëzimit për në Hidrocentralin e Kokelit supozohet të jenë të tipit OPGW, dhe telat lidhës dhe kutitë e lidhjes së kablllove do të instalohen në të dyja shtyllat/kullat.



Figura 1- Konfiguracionet e linjës: qark i dyfishtë 220 kV (majtas) dhe qark i vetëm 110 kV (djathtas)

1.3 Përkufizimi i termave të përdorur

DHP - Devoll Hydropower Sh.A.

OST - Operatori i Sistemit të Transmetimit

MK - Marreveshja e Koncesionit, Ligji 10 083, datë 23.02.2009, i ndryshuar.

Hidrocentrali i Devollit – përfshin hidrocentralin e Banjës, Kokelit dhe Moglicës, sipas përcaktimit në Marreveshjen e Koncesionit.

2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)

Zona në të cilën është planifikuar ndërtimi i linjës së transmetimit në të gjithë gjatësinë e saj, nuk ka një Instrument të Përgjithshëm Vendor të miratuar në KKT.

2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV.

Duke qenë se zona në të cilën është planifikuar ndërtimi i linjës së transmetimit në të gjithë gjatësinë e saj, nuk ka një Instrument të Përgjithshëm Vendor të miratuar në KKT, nuk ka Orientime dhe detyrime që të rrjedhin nga IPV, duke qenë se nuk ka një IPV të miratuar.

2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit

Duke qenë se zona në të cilën është planifikuar ndërtimi i linjës së transmetimit në të gjithë gjatësinë e saj, nuk ka një Instrument të Përgjithshëm Vendor, nuk ka rregulla, norma dhe standarte zhvillimi, të cilat mund t'i referojmë në këtë dokument.

2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim

Duke qënë se zona në të cilën është planifikuar ndërtimi i linjës së transmetimit në të gjithë gjatësinë e saj, nuk ka një instrument të Përgjithshëm Vendor, nuk ka harta, të cilat mund t'i referojmë në këtë dokument.

3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1 Informacion për topografinë e zonës.

Linja e transmetimit 110 kV nënstationi i Hidrocentralit të Banjës –Nënstationi i Cërrikut

Gjurma e linjës OHV që do të lidhë objektet e Nënstationit të Hidrocentralit të Banjës me Nënstationin e Cërrikut, ka një gjatësi totale prej afërsisht 13 km. Gjurma e linjës shtrihet në të djathtë të luginës së lumit Devoll. Fillimi i saj shtrihet në pjesën e poshtme të Digës së Hidrocentralit të Banjës në të majtë të luginës dhe kalon menjëherë në të djathtë (shih prerjen gjatësore) e vazhdon deri në fundin ekzistues të Nënstationit të Cërrikut.

Kjo linjë, si vepër lineare përshkon terrene me veti të ndryshme topografike. Pjesa më e madhe e objektit shtrihet në terrene kodrinore madje deri diku të thyera, në shpate rrëshqitëse; thellohet pjesërisht nga një erozion i theksuar dhe kontraste të forta (pjesa nga pika BC1 deri në Digën e Hidrocentralit të Banjës; mbi fshatin Shtepanj e deri në pikën BC4) dhe më pak në një pjesë kodrinore të butë ose të shtruar (pjesa nga BC4 deri në fshatin Gostime, Shtermenj dhe qytetin e Cërrikut deri në BC6).

Terreni kodrinor shtrihet me një orientim të përgjithshëm si të strukturave të vargmaleve të Shqipërisë Juglindore dhe Veriperëndimore dhe ndërpritet nga një rrjet i fortë përrenjsh malorë që zbresin nga majat e kodrave në drejtim të luginës së lumit Devoll. Këta përrenj janë të shkurtër, por me një ulje të ndjeshme dhe gjatë periudhave me shi kanë një erozion agresiv dhe i thellojnë më shumë shtretërit e tyre duke krijuar shpate më të pjerrëta.

Përveç kësaj, ka pjesë të territorit me një bimësi shkurresh shumë të dendura dhe të forta, të cilat i mbrojnë ato nga fenomenet negative të alterimit dhe degradimi i terrenit; erozioni, etj. Pavarësisht faktit që në disa nga majat e kodrave dhe shpateve ka edhe pyje të vogla që përbëhen kryesisht nga pemë halogjene (që ndodhen kryesisht përreth qytetit të Gramshit), në përgjithësi pjesa më e madhe e terrenit ka ose pak bimësi ose është plotësisht i ekspozuar.

Pjesa tjetër, nga pika BC6 deri në BC9 është plotësisht e rrafshët (nga qyteti i Cërrikut deri në Nënstationin e Cërrikut). Kjo pjesë paraqet terrene kryesisht bujqësore të kultivuara me të mbjella, dhe është e pajisur me rrjete kullimi dhe kanalizime ujërash të zeza.

Kuotat e terrenit variojnë nga 70m deri 350m mbi nivelin e detit.

Pas marrjes përsipër të kësaj detyre, së bashku me ekspertët më të njohur shqiptarë për projektimin e linjës së transmetimit OHL, u krye një inspektim paraprak në terren me harta topografike për të njohur zonën dhe zonat e reja të ndërtimit që nuk janë reflektuar në harta.

Në fillim, u caktua aksi paraprak i kësaj linje dhe, në një fazë të dytë, u krye një inspektim i detajuar për të përcaktuar në mënyrë definitive të gjitha pikat këndore për të shmangur ndonjë ndërtim eventual dhe për të pasur mundësinë e një numri minimal të këtyre këndeve.

Gjetja e zonave të pikave këndore dhe të të gjitha kullave të tjera të suspensionit kërkoj një angazhim shumë të madh, pasi fusha ku kalon linja është kryesisht kodrinore, ka shumë vende të thyera, dhe pjesa e poshtme e saj është pjesërisht e sheshtë.

Në shumicën e rasteve, na u desh të riktheheshim në shumë vende të kësaj zone, pasi disa prej tyre nuk kishin veti të mira sa i përket stabilitetit dhe nuk janë të përshtatshme për vendosjen e objektit të kullave. Kjo zonë ndodhet kryesisht në rrethinat e qytetit të Gramshit. Vargu kodrinor ndërpritet nga një rrjet i zhvilluar rrjedhash ujore malore dhe janë shmangur shumë territore rrëshqitëse; rënia e skarpateve; vendet me rrëshqitje aktive dhe të vjetra që mund të riaktivizohen; etj.


Gjatë inspektimit në terren, janë bërë dokumentimet e të gjitha vendeve ku synohet të ndërtohen kullat dhe janë përshkruar pjesët e ekspozuara të terrenit, ku shihen qartësisht formacionet prej të cilave ato përbëhen.

Përveç kësaj, në zonat me më shumë përgjegjësi janë bërë disa testime të fortësisë së shtresave që mund të dalin në sipërfaqe përmes penetrometrit të dorës dhe "metodës laboratorike në terren".

Përfundimisht, të gjitha këto aktivitete na dhanë mundësinë që të bënim vlerësimin më të mirë të kësaj faze të projektit sa i përket ndërtimit gjeologjik; geomorfologjik; fenomeneve gjeodinamike negative; erozionit; karakteristikave të dheut dhe karakteristikave të shkëmbinjve që hasen në akset e përzgjedhura të gjurmës së linjës.



Relievi në gjurmën e linjës (fotografia e parë paraqet pjesën kodrinore, kurse e dyta pjesën fushore)




Harta për gjeologjinë e dherave për linjën 110kV

3.1.2 Linja e transmetimit 220 kV Nenstacioni i Moglicës – Nenstacioni Elbasan II

Gjurma e linjës OHV, e cila do të lidhë objektet energjetike të Kaskadës së lumit Devoll (Moglica – Elbasan 2) ka një gjatësi totale prej afërsisht 55 km. Gjurma e rrugës së linjës shtrihet në të djathtë të luginës së lumit Devoll. Fillimi i saj shtrihet në zonën e Moglicës, në të djathtë të luginës (shih prerjen gjatësore) dhe vazhdon deri në fundin ekzistues të Nën/Stacionit 440 kV të Elbasanit.

Kjo linjë, si një vepër lineare përshkon terrene me karakteristika të ndryshme topografike. Pjesa më e madhe e objektit shtrihet në terren kodrinore madje deri diku të thyera, shtrihet në shpate rrëshqitëse; thellohen pjesërisht nga një erozion i theksuar dhe kontraste të forta, pjesa nga ME – 1 deri në ME – 2 (Grabovë- Kokli); pjesa nga ME – 18 deri në ME – 23 (Gramsh – Çekin) dhe pjesa tjetër e terrenit kodrinor me karakteristika të një relievi më të butë ose të shtruar. Pavarësisht nga balancimi pozitiv i ujërave të zonës, në përgjithësi duhet të merret parasysh se itinerari i linjës kalon kryesisht nëpër kuota të larta dhe gjithashtu do të merret parasysh përbërja e materialit gjeologjik të formacioneve, të cilat në shumicën e bazamenteve të shtyllave të linjës nuk pritet të kenë ujëra nëntokësore. Ky nivel nuk do të jetë i pranishëm gjatë periudhave të thatësirave dhe atyre me shira (përsa i takon zonave të sheshta) sepse ka një koeficient shumë të ulët filtrimi me përjashtim të disa pjesëve të terracës së lumit me sasi të konsiderueshme të zhavorrit dhe më pak konglomerateve ku prania e ujërave nëntokësorë varet nga sasia e reshjeve dhe ato vërtet që varen vetëm nga ato.



Harta për gjeologjinë e dherave pwr linjën 220kV

3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)

Terreni kodrinor shtrihet me një orientim të përgjithshëm si të strukturave të vargmaleve të Shqipërisë Juglindore dhe Veriperëndimore dhe ndërpritet nga një rrjet i fortë përrenjsh malorë që zbresin nga majat e kodrave në drejtim të luginës së lumit Devoll. Këta përrenj janë të shkurtër, por me një rënie të ndjeshme dhe gjatë periudhave me shi kanë një erozion agresiv dhe i thellojnë më shumë shtretërit e tyre dhe krijojnë shpate më të pjerrët.

Përveç kësaj, ka pjesë të territorit me një bimësi shkurresh shumë të dendura dhe të forta, të cilat i mbrojnë ato nga fenomenet negative të alterimit dhe degradimit të terrenit; erozioni, etj. Pavarësisht faktit që në disa nga majat e kodrave dhe shpateve ka edhe pyje të vogla që përbëhen kryesisht nga pemë halogjene (që ndodhen kryesisht përreth qytetit të Gramshit), në përgjithësi pjesa më e madhe e terrenit ka ose pak bimësi ose është plotësisht i ekspozuar. Gjithsesi, nuk ka një IPV të miratuar, e cila parashikon zona me burime natyrore, mjedise pyjore, përveç atyre burimeve që gjenden në zone në forme natyrale.

Demi i Shkaktuar në pyje (prerje volum druri) do të shoqërohet me rrypëllëzime ku dëmtimi është i madh dhe përsa i përket tokave bujqësore që dëmtohen, ato do të kompesohen në natyrë për humbjet, nëse kalojnë 10 % të ndikimit të pronës së tyre nga projekti.

Ndikimet e kufizuara mjedisore dhe sociale do të ndodhin për periudha të shkurtra gjatë punimeve të ndërtimit që janë marrë përsipër, të trajtuara në Planin e Menaxhimit Social dhe Mjedisor (PMSM). Si rrjedhojë, çështjet e kompensimit që lindin nga dëmtimi ose shkatërrimi i pronave janë marrë përsipër, të trajtuara nëpërmjet Planit të brendshëm për Risistemimin (PVR).

Sipas studimeve kullotat dhe toka bujqësore (përfshirë ullishtet dhe vreshtat) kryesisht hyjnë në rrugët e kalimit të të dyja linjave të transmetimit ndërsa do të preken disa parcela pyjore. Ekziston një hapësirë e madhe toke që është degraduar dhe me mbikullotje, e cila përshkon korridorin e linjës 220 kV. 7-10 shtëpi ndodhen në afërsi të kufirit të rrugës së kalimit 220 kV dhe mund të preken drejtpërdrejt ndërsa 1-2 shtëpi mund të preken nga linja 110 kV.

Ndikimet dytësore ose të tërthorta të punimeve për instalimet e linjave do të jenë shqetësime për trafikun, këmbësorët dhe çështje të sigurisë ku rrugët e kalimit ndodhen përgjatë rrugëve të këmbësorëve dhe ku mund të bllokohen hyrjen në pronën private dhe/ose publike tek zonat e banimit si dhe zonat tregtare.

Pjesa më e madhe e ndikimeve është në fazën e punimeve, dhe kryesisht në punimet e gërmimeve për përgatitjen e kantierëve, bazamentet (për shtyllat e tensionit të lartë), transformatorët dhe vendosjen e linjave ajrore të përcjellësve. Rilevimet tregojnë se tokat bujqësore dhe kullotat (duke përfshirë ullishtat dhe vreshtat) përfshihen

Këto impakte mund të minimizohen për sa i takon ashpërsisë dhe kohëzgjatjes, duke garantuar që punimet e gërmimeve të jenë të kufizuara në seksione të vogla, dhe punimet të kryhen me shpejtësi dhe efikasitet.



Pamje nga territori i thyer kodrinor



Pamje nga territori i gjurmës së linjës



Pjesa që ndodhet rreth Nënstacionit 2 të Elbasanit, më specifikiisht ME – 34 dhe ME – 35 është kryesisht fushore. Kjo pjesë përfaqëson terrene bujqësore dhe është pjesë e terracave lumore të lumit Shkumbin.



Terreni dhe Ujërat

Gjatë kryerjes së inspektimit të hulumtimeve gjeologjike dhe gjeoteknike të gjurmës së linjës, një pjesë e analizës konsistoi në studimin e pranisë ose jo të ujërave nëntokësore.

Kuotat e terrenit variojnë nga 100m (Elbasan) deri në 810m mbi nivelin e detit (Grabovë - Moglicë). Shumica e gjatësisë së madhe të objektit kalon përmes një vargu kodrinor me gjatësi mesatare prej 300-400m.

Në përgjithësi, në zonën përreth ekziston një rrjet i zhvilluar hidrografik lumenjsh, rrymash të mëdha ose të vogla, të tilla si Lumi i Devollit, i cili rrjedh paralel me strukturat tona gjeologjike dhe disa rryma (degë të këtij lumi) që i ndërpresin direkt këto struktura dhe derdhen në Lumin e Devollit. Këto rryma janë të shumta për shkak të gjatësisë së gjurmëve të linjës si Limçe; Broshiku; Përroi i Thellë; Gramshi; Kocuji; Çekreze; Holtë; Gostimë, etj. Janë të vogla dhe kanë një rrjedhje të madhe ujërash gjatë periudhave me shira dhe më pak gjatë thatësirave; rrymat më të vogla thahen fare përkohësisht.

Krahas kësaj, në zonën e sheshtë (duke pasur parasysh disa grumbuj afër me Nënstacionin II të Elbasanit), prania e ujërave nëntokësore është kudo. Ky nivel varion nga një pjesë tek një tjetër dhe varet nga përbërja e dherave dhe gjithashtu nga luhatja e nivelit të ujërave të Lumit Shkumbin.

Këto ujëra nëntokësore janë pa ngjyrë dhe erë dhe nuk janë agresive ndaj hekurit dhe betonit.

3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Nga verifikimet dhe inspektimet e kryera në zonën e planifikuar për ndërtimin e të dy linjave të transmetimit, nuk rezulton të ketë zona të mbrojtura natyrore apo ato të trashëgimisë kulturore dhe historike.

3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj.

Nga studimi i kryer, pas përfundimit të punimeve do të ketë përfitim të konsiderueshëm neto pozitiv social dhe mjedisor për popullsinë shqiptare për shkak të stimulit socio-ekonomik të ofruar nga kapaciteti i rritur i prodhimit të energjisë.

Pjesa më e madhe e ndikimeve hyn në fazën e ndërtimit, kryesisht punimet e gërmimit për përgatitjen e vendpunimit, punimet e themeleve, ngritjen e shtyllave/kullave dhe lidhjen e përcjellësve ajrorë.

Ndikime sociale ekonomike të shkurtra të lidhura me punimet e ndërtimit. Pronarët e tokës do të kompensohen për marrjen e tokës përgjithmonë nga ngritja e shtyllave, humbja e përkohshme e të ardhurave nga të korrat si pasojë e pastrimit dhe mirëmbajtjes së vendit me të Drejtë Kalimi dhe vlerë të reduktuar të pronës për shkak të pranisë së linjës së transmissioinit. Çdo shtëpi apo fermë e prekur direkt do të risistemohet dhe do të kompensohet.

3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës së Gjendjes Ekzistuese

Nga vlerësimi i kryer për ndikimet, pranueshmëria mjedisore e projektit mund të përmblihet si më poshtë:

Ekologjia Tokësore: Nuk do të preket asnjë habitat me cilësi të lartë përveç disa pjesëve të bimësisë lokale (Maquis) dhe pjesët e mbjellura me pisha. Megjithatë një pjesë e vogël e Linjës së Transmissioinit kalon nëpërmjet një habitati të arinjve dhe ujqërve, impaktet janë parashikuar të jenë minimale.

Cilësia e Ujit: Ndikimet negative serioze të mundshme mbi cilësinë e ujërave nëntokësore mund të vijnë nga rrjedhjet aksidentale ose rrjedhjet e vajrave, lubrifikantëve nga makineritë e ndërtimit dhe/ose transformatorët. Risku i impakteve të tilla do të duhet më pas të menaxhohet nëpërmjet procedurave të sigurisë dhe instalimit të strukturave për parandalimin e rrjedhjeve (d.m.th për transformatorët).

Cilësia e ajrit dhe zhurmat: Ndikime negative të vogla të lidhura me pluhurat, tymrat dhe zhurmat nga punimet dhe shpërthimet e shkëmbinjve.

Peizazhi: Impakte negative shumë të vogla dhe më së shumti të përkohshme të lidhura me kantieret e punimeve. Pamjet e peizazhit do të pikëzohen me shtylla të LT, të cilat mund të mos jenë të kënaqshme nga ana estetike për disa njerëz.

Punimet që do të kryhen për rrjetin ndërlidhës të transmetimit do të sjellin marrjen e kufizuar të tokës për nënstacionet dhe bazamentet e shtyllave. Krahas kësaj, për të mundësuar vendosjen e linjave ajrore të përcjellësve (konduktorëve) dhe mirëmbajtjen e linjave, do të jetë e nevojshme pastrimi i terrenit për të Drejtën e Kalimit. Një pastrim i tillë parashikohet të jetë shumë i kufizuar në përmasa dhe i lokalizuar aty ku linjat kryqëzohen me plantacione ekzistuese pemësh ose tokë të kultivuar me ullinj.

Sa të jetë e mundur itinerari i rrjetit të propozuar është realizuar në atë mënyrë që të evitohet konflikti me shtëpitë ekzistuese dhe habitatet e posaçme (p.sh. pyjet e mbetur) shpatet e thepisur

me tendencë erozioni dhe hapjen e rrugëve të reja. Shkatërrimi i shtëpive dhe çdo zhvendosje apo risistemim i njerëzve ka të ngjarë të jetë shumë i kufizuar. Nëse dëmtohen pronat ose sille të shqetësim në jetët e njerëzve, Plani për Risistemim është përgatitur për të bërë kompensimin e këtyre veprimeve.

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave

Një pjesë e parcelave të propozuara për ndërtimin e të dy linjave të transmetimit shërbejnë për aktivitete bujqesore të vetë pronarëve të zonës ku do të ndërtohen këto linja. Këto pasuri kanë kaluar përmes një procesi shpronësimi përmes VKM-së së shpronësimit nr. 661, datë 7.8.2013. Pjesa tjetër e shtyllave të linjave është e vendosur në hapësira kodrinore kryesisht, e drejta e kalimit nëpër të cilat është dhënë përmes Urdhrit të Ministrisë së Mjedisit nr. 506, datë 22.05.2013.

4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa

Në ndërtimin e të dyja linjave të transmetimit, nuk vihet re asnjë ndërtesë e cila të preket nga aktivitetet e linjave. P.sh. edhe një strukturë me qëllim banimi që ndodhet në afërsi të korridorit të linjës së transmetimit (ndërtim pa leje), për arsye se sipas standarteve me të mira teknike nuk lejohet të qëndrojë në afërsi të linjës për arsye sigurie (HSE), nga ana e Kompanisë DHP është zbatuar Plani Social për risistemimin e kësaj banese në një vend tjetër. DHP-ja ka marrë përsiper kostot e projektimit, ndërtimit dhe ri-sistemimit të kësaj familje duke konsideruar anën sociale.

4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave

Kjo pikë është e vlefshme vetëm për nënstacionet pjesë e linjave të transmetimit. Për nënstacionet nuk do të ketë trajtim të fasadave, trajtim të mbulesave, pasi janë ndërtesa ekzistuese dhe nuk do të ketë punime shtesë në to.

4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë

Treguesit për zhvillim janë të paraqitur në raportin e plotë topografik për çdo shtyllë të të dyja linjave, pjesë e aplikimit për miratimin e lejes zhvillimore komplekse.

4.5 Rregullat e zhvillimit

Projektimi/ Zhvillimi/ Zbatimi i projektit të ndërtimit të linjave është kryer bazuar në rregulloret në fuqi të projektimit, KTP e vitit 1978 dhe standardeve ndërkombëtare të projektimit kur nuk përcaktohet në këtë rregullore.

4.6 Vendqëndrimi për automjetet

Kjo pikë nuk është relevante për këtë lloj projekti. Në projekt nuk janë parashikuar vendqëndrime për automjete, pasi një pjesë e shtyllave elektrike, janë në terren të thyer dhe të paaksesueshme nga automjetet. Në vendndodhjet e tjera, nuk ka parashikime të vendqëndrimeve të reja për automjete, pasi janë ato ekzistuese.

5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës

5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

5.1.1 Rrjeti Rrugor

Secila nga shtyllat do të ketë rrugën e aksesit për kryerjen e punimeve në të si edhe me vonë të mirembajtjes nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike

Vetë aktiviteti/ ndërtimi i linjave do të shërbejë për transmetimin e energjisë së prodhuar nga hidrocentralet. Energjia që do të prodhohet nga hidrocentrali i Banjës, do të transmetohet përmes linjës 110 kV në nënstationin e Cërrikut (Banjë – Cërrik) (dhe energjia që do të prodhohet nga hidrocentrali i Moglicës, do të transmetohet përmes linjës 220kV në nënstationin Elbasan II (Moglicë – Elbasan II).

5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit

Të dyja linjat e transmetimit si edhe elementet e tyre i përmbahen aktit teknik të kryer me 07.07.2014. Nënstationi Elbasan II dhe ai i Moglicës do të pajisen me sistem të mbrojtjes kundër zjarrit. Kjo kërkesë nuk është e detyrueshme për linjat e transmetimit. Në vijim, po ju përcjellim edhe detaje të këtyre elementëve.

Tokëzimi i shtyllës për 220 kV

Sistemi i tokëzimit për secilën shtyllë do të bazohet tek matjet e rezistencës së tokës. Zakonisht elektrodën në sipërfaqe të tokës (të instaluar në 0.8 deri 1m nëntokë) do të jenë rrip çeliku i galvanizuar me zinkim të nxehtë 40x4 mm dhe të instaluar në një mënyrë të tillë që të sigurohet germim i mundshëm rreth shtyllës. Nëse do të jetë nevoja, krahas tyre do të zbatohen elektrodën (shufra) për thellësi më të madhe.

Izolatorët për 220 kV

Për të gjitha izolatorët e tensionit dhe izolatorët e varur do të përdoren izolatorë porcelani kupë dhe bosht të zakonshëm U120B në përputhje me IEC 60305. Shtyllat këndore dhe shtyllat e varura do të pajisen me dy përcjellës të varur (2 njësi x16 U120B) dhe kullat e varura me një përcjellës të varur (njësitë 15 U120B). Në kryqëzimet me rrugët kryesore publike, linjat hekurudhore dhe linja të tjera transmisioni do të përdoren përcjellësit e dyfishtë të varur.

Tokëzimi i shtyllës për 110 kV

Sistemi i tokëzimit për secilën shtyllë do të bazohet tek kriteret e tokës. Zakonisht elektrodën në sipërfaqe të tokës (të instaluar në 0.8 deri 1m nëntokë) do të jenë në mënyrë tipike rrip çeliku i galvanizuar me zinkim të nxehtë 40x4 mm dhe të instaluar në një mënyrë të tillë që të sigurohet germim i mundshëm rreth shtyllës. Nëse do të jetë nevoja, krahas tyre do të zbatohen elektrodën (shufra) për thellësi më të madhe.

Izolatorët për 110 kV

Për të gjithë izolatorët e tensionit dhe izolatorët e varur do të përdoren izolatorë porcelani kupë dhe bosht të zakonshëm U70B në përputhje me IEC 60305. Shtyllat këndore dhe shtyllat

e varura do të pajisen me dy përcjellës të varur (2 njësi x9 U70B) dhe kullat e varura me një përcjellës të varur (njësitë 8 U70B). Në kryqëzimet me rrugët kryesore publike, linjat hekurudhore dhe linja të tjera transmisioni do të jenë përcjellësit e dyfishtë të varur.

I gjithë investimi per Projektin Hidroenergjitik të Devoll zhvillohet ne bazë të Praktikës më të Mirë të Industrise në fushën e Hidrocentraleve dhe linjave te transmetimit, duke pasur parasysh edhe zbatimin e legjislacionit shqiptar.

5.1.4 Impianti i shkarkimit të ujërave të zeza

Nuk parashikohen ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese te nënstacioneve/ godinave ekzistuese. Për këtë arsye, nuk parashikohen impiante të shkarkimit të ujërave të zeza.

5.1.5 Impianti i furnizimit me ujë

Nuk parashikohen ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese te nënstacioneve/ godinave ekzistuese. Për këtë arsye, nuk parashikohen impiante të furnizimit me ujë.

5.1.6 Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut

Nuk do të ketë impiant të shkarkimit të ujërave të shiut. Nuk parashikohen ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese te nënstacioneve/ godinave ekzistuese. Për këtë arsye, nuk parashikohen impiante të shkarkimit të ujërave të shiut.

5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Nuk parashikohet krijimi i hapësirave të lira dhe të gjelbërta. Sipas Urdhrit të Ministrisë së Mjedisit nr. 506, datë 22.05.2013 parashikohet pyllëzimi dhe përmirësimi i një sipërfaqeje prej 41 ha, nga ndikimi që këto linja transmetimi kanë në mjedisin pyjor, kullota dhe livadhe.

6. Fazat e Zhvillimit te Lejes Zhvillimore Komplekse

DEVOLL HYDROPOWER Linja e Transmetimit & Nënstacionet Elektrike Grafiku i Punësive DRAFT						
№	Titulli	Start	Fund	Shprehje	Shprehje	
1	Mogjoll - Elbasan 1 220 kV Linja e Transmetimit dhe Nënstacionet	04.08.2011	04.01.2014	91.44%	100%	
2	Stacioni dhe Transmetimi	04.08.2011	11.07.2014	99.99%	100%	
3	Nënstacioni Elektrik Nënstacioni	04.01.2014	04.01.2014	100.00%	100%	
4	Transmetimi - Nënstacioni dhe Nënstacioni i Linjave të Ngjashme të tjera	11.07.2014	11.07.2014	100.00%	100%	
5	Lidhja e Linjave të Nënstacionit Elektrik i përbashkët	11.07.2014	11.07.2014	100.00%	100%	
6	Stacija - Devoll 110 kV Linja e Transmetimit dhe Nënstacionet	04.08.2011	04.01.2014	91.44%	100%	
7	Stacioni dhe Transmetimi	04.08.2011	11.07.2014	99.99%	100%	
8	Nënstacioni Elektrik Nënstacioni	04.01.2014	04.01.2014	100.00%	100%	
9	Transmetimi - Nënstacioni dhe Nënstacioni i Linjave të Ngjashme të tjera	11.07.2014	11.07.2014	100.00%	100%	
10	Lidhja e Linjave të Nënstacionit Elektrik i përbashkët	11.07.2014	11.07.2014	100.00%	100%	

Ndërtimi i këtyre linjave përfshin dy faza:

1. Ndërtimi i linjës 220 kV përfshin periudhën Shtator 2013 – tetor 2014
2. Ndërtimi i linjës 110 kV përfshin periudhën janar 2015 – shkurt 2016

7. Relacionin e menaxhimit të inerteve të dalta si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

Lidhur me këtë pikë, Kontraktori për kryerjen e punimeve do të ndjekë parimim gërmobush, që do të thotë materialet që do të gërmohen do të përdoren për mbushjen e gropave të themeleve.

Inertet e nxjerra nga gërmimet do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi. Gropa për depozitimin e tyre janë caktuar në bashkëpunim me pushtetin lokal. Nuk pritet që të ketë shumë inerte pasi, shtyllat e linjave të transmetimit janë me bazament të vogël.

Lidhur me këtë pikë, Investitori, në kontratat që ka nënshkruar me Kontraktorët për Zbatimin e Punimeve, ka caktuar një Shtojcë të vecantë në Kontratë, "Plani i Veprimit dhe Menaxhimit Mjedisor", i krijuar në zbatim të standardeve të IFC-së, i cili përfshin Masat për zvogëlimin e erozionit, ri-pyllëzimin, krijimin e nën-planeve për depozitimin e mbetjeve, nën-planet për karrierat që do të përdoren, dhe sheshet e Ndërtimit, kontrolli i sedimenteve, cilësia e ajrit, zhurmat dhe kontrolli i lëndëve plasëse, menaxhimi i materialeve të rrezikshme si dhe programe trajnuese të personelit që merren me to, monitorimi i vazhdueshëm i këtyre proceseve, etj.

8. Impaktet Kryesore në Mjedis

Nga vlerësimi i kryer për impaktet, pranueshmëria mjedisore e ndërtimit të linjave të transmetimit mund të përmblihet si më poshtë:

Cilësia e ajrit dhe zhurmat: Impakte negative të vogla të lidhura me pluhurat, tymrat dhe zhurmat nga punimet dhe shpërthimet e shkëmbinjve.

Peizazhi: Impakte negative shumë të vogla dhe më së shumti të përkohshme të lidhura me kantieret e punimeve. Pamjet e peizazhit do të pikëzohen me shtylla të LT, të cilat mund të mos jenë të kënaqshme nga ana estetike për disa njerëz.

Mjedisi Social, Ekonomik dhe Kulturor: Impakte social ekonomike të shkurtra të lidhura me punimet e ndërtimit. Pronarët e tokës do të kompensohen për marrjen e tokës përgjithmonë nga ngritja e shtyllave, humbja e përkohshme e të ardhurave nga të korrat si pasojë e pastrimit dhe mirëmbajtjes së vendit me të Drejtë Kalimi dhe vlerë të reduktuar të pronës për shkak të pranisë së linjës së transmisionit. Çdo shtëpi apo fermë e prekur direkt do të risistemohet dhe do të kompensohet.

Lehtësimi i pasojave është i mundur nëpërmjet një plani menaxhimi social dhe mjedisor në kombinim me planifikimin e duhur për risistemin.

8.1 Impakt mbi sipërfaqen e tokës

Ekologjia Tokësore: Nuk do të preket asnjë habitat me cilësi të lartë përveç disa pjesëve të bimësisë lokale (Maquis) dhe pjesët e mbjella me pisha. Megjithëse një pjesë e vogël e Linjës së Transmisionit kalon nëpërmjet një habitati të arinjve dhe ujçërve, impaktet janë parashikuar të jenë minimale.

8.2 Impakt mbi ujërat sipërfaqësore

Shkumbini dhe degët e lumit Devoll (Zalli i Gostimës, Shushica, Holta, Plakalinj, Çekrezi, Vërça dhe Grabova) janë habitate të rëndësishme për llojet e kafshëve të lidhura me habitatet e ujërave të ëmbël të rrjedhshëm, si p.sh. pilivesat, peshqit, amfibët (*Rana graeca*, *R. dalmatina*, dhe *R. temporaria*), shpendët ujqorë (*Alcedo atthis* dhe bishtlëkundësit (fam. *Motacillidae*). Ky habitat është gjithashtu i rëndësishëm për lundrën (*Lutra lutra*). Rilevimet në terren për jetën e ujit, të kryera si pjesë e rilevimeve bazë të procesit VNMS-së veçanërisht rilevimi për lundrat, tregojnë se bota lumore e lumit Devoll, duke përfshirë degët e tij kryesore të përmendura më lart është akoma e shëndetshme, sado që popullsia e lundrave është e ulët, dhe shpërndarja e tyre varet shumë nga ushqimi dhe strehimi, rrjedha e ujit dhe niveli i tij në lumë, i cili luhetet shumë sipas stinëve.

8.3 Impakt mbi ujërat nëntokësore

Impaktet negative serioze të mundshme mbi cilësinë e ujërave nëntokësore mund të vijnë nga rrjedhjet aksidentale ose rrjedhjet e vajrave, lubrifikantëve nga makineritë e ndërtimit dhe/ose transformatorët. Risku i impakteve të tilla do të duhet më pas të menaxhohet nëpërmjet procedurave të sigurisë dhe instalimit të strukturave për parandalimin e rrjedhjeve (d.m.th për transformatorët).

8.4 Impakt mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

Karakteristikat specifike të linjave të transmetimit 220 kV dhe 110 kV përsa i takon bimësisë/mbulesës së tokës janë:

Për linjën e transmetimit 220 kV

Zona karakterizohet nga një grykë me reliev të lartë, ku linja lidhet me HEC-et e rrjedhës së sipërme, gradualisht në kodra më të valëzuara ndërsa linjat kalojnë nëpër luginën e Devollit në Gramsh e më tej.

Bimësia karakterizohet nga pyje të degraduar të dominuar nga shkurnajat *Macchia*, lisi gjetherënës dhe parcela me pisha të zeza dhe tokë të punueshme, disa prej të cilave përdoren për ullinj, frutore dhe vreshta.

Linja kalon një numër përrenjsh dhe degësh lumore që krijojnë ekologjinë ujore të zonës.

Për linjën e transmetimit 110 kV

Përpara se të mbërrijë në Nënstacionin e Cërrikut, linja kalon nëpër kodrina të mbuluara me shkurnaja *Macchia*, pyje të degraduar të dominuar nga lisi gjetherënës dhe pjesërisht të mbuluar nga ullishtat dhe pothuajse tërësisht me tokë të punueshme dhe shumë zona të tjera

më pak të transformuara të përdorura kryesisht për të korra, vreshta dhe pemë të tjera frutore. Më tej në veri, pranë fshatit Gostimë, linja e transmisionit bashkohet me lumin Zalli i Gostimës. Bashkimi bëhet në vendin me pyje bregore të rajonit. Zona e studimit karakterizohet nga një numër i madh kanalesh ujitjeje dhe drenazhimi.

Fauna e Korridorit të Linjës së Transmetimit

Korridorit i Linjës së Transmisionit mban një gamë me habitate natyrore, gjysmë natyrore dhe artificiale, karakteristike të zonave rurale të banuara dhe të shfrytëzuara gjerësisht. Për rrjedhojë shumica e jetës së egër (speciet e kafshëve) janë ato të lidhura me pyjet e degraduar (lisa të përzier) të përdorur për dru zjarri dhe kullota. Shkurnaja mesdhetare (maquis), plantacione pishash, kullota, toka bujqësore, vreshta, ullishta, dhe toka bujqësore të braktisura.

Shumica e lumenjve dhe degëve të tyre mbajnë një jetë relativisht modeste për peshqit, të dominuar nga lloji Cyprinids, nga i cili më të zakonshmit janë ato të barbuni i Prespës, spiralin, pindus stone dhe stone loach. Ndonjë Troftë e vetme (*Salmo trutta fario*) nganjëherë mund të vëzhgohet/kapet në rrjedhën e sipërme të degëve të Devollit, në Holtë dhe Vërçë.

Vendi rrallë përdoret si vend ushqimi për mishngrënësit e mëdhenj të tillë si ariu (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*).

8.5 Impakt mbi menaxhimin e tokës dhe mbetjeve

Mbetjet e paketuara që do të krijohen nga pajisjet elektrike do të riciklohen sa herë që të jetë e mundur, ose të dërgohen në landfillet lokale të miratuara. Kur nuk ekzistojnë vendet e asgjësimit të këtyre mbetjeve, duhet të krijohen.

8.6 Impakt mbi Peizazhin

Impaktet negative shumë të vogla dhe më së shumti të përkohshme të lidhura me kantieret e punimeve. Pamjet e peizazhit do të pikëzohen me shtylla të LT, të cilat mund të mos jenë të kënaqshme nga ana estetike për disa njerëz.

8.7 Impakt mbi Zhurmat dhe ajrin

Impaktet nga pluhurat dhe zhurmat mund të ndodhin me një shpeshtësi dhe intensitet që lidhet me vendndodhjen gjeografike të këtij projekti afër me rrugën dhe aktivitetet e punimeve. Mund të ketë impakte negative mbi bletët, shëndetin e njerëzve dhe largimin e kafshëve nëse nuk merren masa paraprake. Megjithatë, njihen përfitimet e përmirësimit të infrastrukturës që kundërpeshon këtë shqetësim. Gjithsesi, rëndësia e impaktit përpara masave zbutëse vlerësohet si mesatarisht e ulët. Për këto arsye, do të kërket parasysh implementimi i masave për reduktimin e pluhurit dhe zhurmave.

8.8 Impakt mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë



Nuk pritet të ketë asnjë ndërprerje kulturore të rrjeteve sociale.

9. Anekse (Hartat në format A3)

1. Harta e planvendosjes së linjës së transmetimit 110 kV HEC Banje – Nënstacioni Cërrik
2. Harta e planvendosjes së linjës së transmetimit 220 kV Nënstacioni Moglicë – Nënstacioni Elbasan II dhe pikat e lidhjes me infrastrukturën

LEJE ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT :

VEPRA: LINJA E RE E TRANSMETIMIT 110kV dhe 220kV PËR LIDHJEN E PROJEKTIT HIDROENERGJITIK TË DEVOLLIT NË RRJETIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT
MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T
z. EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETARE
znj. Eglantina Gjermeni
Ministër i Zhvillimit Urban dhe Turizmit

z. Damian Gjiknuri
Ministër i Energjisë dhe Industrisë



MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-46 NR. 3 DATË 30-07-2014

OBJEKTI: PLANI PËR LIDHJEN E TRANSMETIMIT 110kV/220kV PËR LIDHJEN E PROJEKTIT HIDROENERGJITIK TË DEVOLLIT NË RRJETIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

FAZA E PROJEKTI: PROJEKTIM I DETAJLUAR

INVESTITORI: Devoll Hidroenergjik

PROJEKTOR: BOKO

Emërtim i Bete: BOKO

Skala: 1:50 000

Shprehje: 1:50 000

116/11/2014

ALBANI

